

STATUTI

Statuti i shoqatës jofitimprurëse “LIQENI I BREZNËS”

1. Informacionet bazë

Shoqata “Liqeni i Breznës”

c/o Wiesenstrasse 1
9463 Oberriet SG
Schweiz

Tel: +41 76 396 5678

shoqata@brezne.com

www.brezne.com

Lloji

OJQ – Organizatë jofitimprurëse

Nr. i regjistrimit

Kryesia

Sami Kryeziu
(Kryetar)

Labinot Pirkuqi
(Arkëtar)

Munib Lecaj
(Sekretar)

Themeluesit

Alban Gashi	Fikret Kryeziu	Salla Shala
Arafat Shala	Gadaf Shala	Sami Kryeziu
Armend Krasniqi	Kenedi Shala	Sarand Krasniqi
Bajram Shala	Labinot Pirkuqi	Vajdin Gashi
Besart Krasniqi	Leutrim Krasniqi	Visar Kryeziu
Blerim Krasniqi	Mehmed Krasniqi	Vitor Gashi
Edin Kryeziu	Muharrem Krasniqi	
Elbasan Kryeziu	Munib Lecaj	
Euran Shala	Nadir Gashi	
Femi Kryeziu	Nermin Gashi	

Data dhe vendi

02.03.2025

Regensdorf - ZH

Zvicër

2. Prezantimi

Neni 1

1.1 Shoqata “Liqeni i Breznës” me selitë në Zvicër dhe Kosovë është shoqatë jofitimprurëse, jopartiake, joqeveritare, jofetare, e themeluar nga një grup qytetarësh të fshatit Brezne ku si qëllim ka lidhjen e banorëve kudo që jetojnë dhe kanë prejardhje nga fshati Brezne. Shoqata ka si qëllim primar bashkëpunimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të ndryshme përmes iniciativave individuale apo grupore që shkojnë në interes të fshatit Brezne dhe ruajtjen e vlerave kulturore në diasporë.

1.2 Kjo shoqatë është e krijuar me vullnetin e lirë të anëtareve të saj.

1.3 Emri i shoqatës do të jetë, **Shoqata “Liqeni i Breznës”** dhe mund të përdoren edhe inicialet SH.L.B apo vetëm “Liqeni i Breznës”

1.4 Shoqata ka emblemën dhe logon e vet të përcaktuar nga anëtarët e kryesisë.

1.5 Selitë dhe adresat e shoqatës gjenden në kantonin St. Gallen të Zvicrës dhe fshatin Brezne të Kosovës . Lokacionet e selive i aprovojnë anëtarët e kryesisë.

1.6 Shoqata ka 2 degë (Baza 1 në Zvicër dhe Baza 2 në Kosovë). Shkaku i ligjeve në fuqi, degët kanë statute të ndara por veprimtaria e tyre bazohet në një ombrellë të përbashkët me të drejta të barabarta. Sqarimet shtesë do jepen përmes rregulloreve sipas nevojës.

Neni 2

2.1 Pjesë e shoqatës mund të jenë të gjithë personat, kudo që jetojnë dhe që kanë lidhje familjare me banorët e fshatit Brezne (nipat, mbesat, stërnipat, stërmbesat). Shoqata i përket të gjitha grup moshave me të drejta të barabarta. Vendimet për personat nën moshën 18 vjeçare sqarohen përmes një rregullore të veçantë.

2.2 Anëtarët jashtë lidhjeve familjare me fshatin Brezne nuk kanë të drejtë vote por ata mund të marrin pjesë në aktivitetet e shoqatës të caktuara me një rregullore në bazë të aktivitetit. Nëse japin kontribut në interes të shoqatës, duke u bazuar në statutin dhe rregulloret tjera, ata do i quajmë anëtarë nderi në bazë të kontributit që do japin.

3. Informimi

Neni 3

3.1 Gjuha

- a) Gjuhët zyrtare janë: Gjermanisht dhe Shqip
- b) Statuti me informacione bazike është në gjuhën Gjermane ndërsa statuti në detaje është në gjuhën Shqipe
- c) Gjuhët përdorën sipas nevojës dhe aktiviteteve të shoqatës

3.2 Webfaqja zyrtare e shoqatës është portali i përbashkët i fshatit Brezne www.brezne.com

3.3 Shoqata “Liqeni i Breznës” ka hapësirën e veçantë tek linku me url www.brezne.com/shoqata dhe gjithashtu një hapësirë tek faqja kryesore e portalit si dhe sistemin digjital për menaxhim

3.4 Të gjitha materiale nën hapësirën tek Neni 3.3 janë pronë e shoqatës dhe kryesia e shoqatës vendos se si mund të përdorën materialet

3.5 Të gjithë informacionet zyrtare, deklaratat, takimet, vendimet si dhe informacionet tjera të nevojshme, do të publikohen tek webfaqja zyrtare Neni 3.2 dhe Neni 3.3

3.6 Disa informacione, dokumente dhe publikime tjera, do kenë qasje të kufizuar vetëm për anëtarët e shoqatës d.m.th qasja e tyre do jetë në formën digjitale përmes postës elektronike (e-mail) ose sistemi digjital ku anëtarët do ketë qasje pas aprovimit nga stafi përgjegjës.

3.7 Të gjitha informacionet zyrtare do jenë të hapura për anëtarët e shoqatës ndërsa vendimet, procesverbalet do ju dërgohen anëtarëve të kryesisë 1 javë para se të publikohen tek portali zyrtar. Anëtarët e kryesisë kanë për obligim të lexojnë dhe kanë të drejtë të japin vërejtje apo komente tjera. Nëse nuk ka reagime, procesverbali hyn në fuqi dhe nuk diskutohet më d.m.th dokumenti arkivohet në shoqatë.

3.8 Shoqata “Liqeni i Breznës” do ketë edhe kanale tjera informuese si; rrjetet sociale (WhatsApp, Facebook) apo kanale tjera për të cilat vendos kryesia. Të gjitha këto kanale mbetën pronë e shoqatës të bazuara sikurse tek Neni 3.5

4. Dokumentet

Neni 4

Anëtarët themelues të shoqatës janë qytetarë që vijnë nga fshati Brezne të cilët jetojnë në Zvicër. Lista e anëtareve themelues është cekur në faqen e parë tek Informacionet bazë.

Neni 5

Dokumentet zyrtare

5.1 Shoqata ka statutin në dy gjuhë (Gjermanisht dhe Shqip)

5.2 Shoqata ka vulën e vet të shkruar në dy gjuhë, Gjermanisht dhe Shqip.

5.3 Gjuhët në dokumentet zyrtare mund të përdorën sipas nevojës

Neni 6

Për ruajtjen e vulës kujdeset kryetari dhe arkëtari i shoqatës, dhe mund të përdoret vetëm nga persona të autorizuar me vendim të kryesisë së shoqatës.

Neni 7

Shoqata është formuar për një kohë të pacaktuar d.m.th. aktivitetet do të zgjasin derisa ka vullnet nga anëtarët në menaxhimin e aktiviteteve.

5. Veprimtaria

Neni 8

Veprimtaria e shoqatës ushtrohet në të gjithë shtetet ku së paku jetojnë 5 banorë me prejardhje nga fshati Brezne. Qendrat kryesore do jenë të ndara në 4 grupe të përfaqësuara në shtete:

- ✓ Grupi 1: Zvicër (baza 1), fshati Brezne / Kosovë (baza 2)
- ✓ Grupi 2: Austri, Gjermani, Slloveni
- ✓ Grupi 3: Finlandë, Suedi, Danimarkë, Belgjikë, Bosnje, Kroaci, Itali
- ✓ Grupi 4: Shtetet tjera

8.1

Motoja e shoqatës:

Ruajtja e vlerave kulturore dhe lidhja me atdheun

8.2

Aktivitetet

a) Kulturore

1. Ruajtja e gjuhës tek fëmijët
2. Ruajtja e traditave dhe kulturës
3. Festimi i festave kombëtare
4. Më afër njëri tjetrit

b) Atdheu

1. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me atdheun
2. Angazhimi në mirëmbajtjen e fshatit
3. Përgatitja e festave për diasporën
4. Përgatitje e kushteve për vizitën në atdhe

c) Lidhja

1. Lidhja dhe bashkëpunimi me banorët e fshatit kudo që jetojnë
2. Shkëmbimi i përvojave nga mbarë bota ku ka banorë me prejardhje nga f.sh. Brezne

d) Përkrahja e aktiviteteve në atdhe

1. Po
 - i. Mirëmbajtja e vendeve publike të fshatit
 - ii. Iniciativat që sjellin zhvillim, punësim, prodhim dhe edukim
 - iii. Iniciativat që përkrahin fëmijët dhe rininë
 - iv. Problemet grupore duke marrë parasysh kërkesat e banorëve
 - v. Kujdesi ndaj pensionistëve përmes aktiviteteve grupore
 - vi. Përgatitja e aktiviteteve për diasporën gjatë pushimeve verore
2. Jo
 - i. Problemet individuale
 - ii. Shëndetësore
 - iii. Bamirësi
 - iv. Biznese
3. Pjesërisht

- i. Bashkëfinancim – nëse ndonjë palë merr iniciativë në interes të fshatit
 - ii. Në programet e qeverisë – nëse kërkohet bashkëfinancim i pjesshëm
- 4. Shqyrtim
 - i. Rastet shumë të veçanta dhe vendimi vjen me votim të fshehur nga të gjithë anëtarët që kanë dhënë kontribuar financiarisht
 - ii. Përkrahja e personave me aftësi të kufizuara (si grup)
- e) Financimi i aktiviteteve të shoqatës
 - 1. Po
 - i. Shpenzimet bazike të mbledhjeve
 - ii. Shpenzimet e administratës dhe gjërave teknike
 - iii. Shpenzimet në mbajtjen e aktiviteteve kulturore
 - iv. Pagesa në shuma simbolike apo dhurata për fëmijët nëse marrin pjesë si valltare, recitime apo aktivitete tjera gjatë festave kombëtare
 - 2. Jo
 - i. Pagesë për anëtarët e bordit drejtues dhe kryesisë
 - ii. Pagesë për punën e punëtorëve vullnetar
 - 3. Pjesërisht
 - i. Udhëtimet për çështjet e shoqatës
 - ii. Përgatitja e planit për mbledhjen e fondeve bazuar nga Neni 13.2
 - 4. Shqyrtim
 - i. Shërbimet ose produktet që ja lehtësojnë punën shoqatës
- f) Bashkimi i të gjithë banorëve me prejardhje nga fshati Brezne
 - 1. Zhvillimi i kanaleve të komunikimit
 - 2. Hapja e degëve në shtetet e Grupit 2 bazuar nga Neni 8
 - 3. Mbajtja e takimeve online me grupe të ndryshme
 - 4. Vizita dhe shkëmbime tjera në interes të shoqatës
- g) Ambienti
 - 1. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit natyror
 - 2. Kujdesi ndaj mbeturinave në territorin që i takon fshatit Brezne

6. Qëllimi

Neni 9

9.1 Shoqata ka si qëllim primar bashkëpunimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të ndryshme përmes iniciativave individuale apo grupe që shkojnë në interes të fshatit Brezne dhe ruajtjen e vlerave kulturore, traditat, gjuhën, bashkëpunimin në mes veti etj.

9.2 Plani afatgjatë rreth qëllimeve të shoqatës do të ndërtohet gjatë punës 1 vjeçare dhe do të publikohet në faqen zyrtare me qasje duke u bazuar nga Neni 3.6

7. Anëtarësimi

Neni 10

Regjistrimi dhe përfitimet

10.1 Informacionet rreth regjistrimit të anëtarëve dhe përfitimet do ju dërgohen të gjithë banorëve përmes kanaleve informuese duke u bazuar nga Neni 3

10.2 Anëtarë i shoqatës mund të bëhet çdo person i cili plotëson kushtet tek Neni 2.1, Neni 2.2 si dhe pranon parimet themelore të statutit të shoqatës dhe i respekton ato.

10.3 Anëtarësimi dhe veprimet kulturore të anëtarëve të shoqatës bëhen në bazë të parimeve vullnetare. Anëtarësimi nuk është detyrues.

10.4 Rregullorja dhe përfitimet e çdo anëtari si pjesë e shoqatës, do të ndërtohet gjatë punës në mandatin e parë 1 vjeçar ku do sqarohet saktësisht roli dhe të drejtat për secilin grup.

10.5 Anëtar i shoqatës konsiderohet çdo person i cili pranon statusin, pranon rregullat e anëtarësisë dhe paguan shumën vjetore të caktuar nga kryesia e shoqatës.

10.6 Shuma e anëtarësisë përcaktohet nga anëtarët e kryesisë së shoqatës dhe pagesa është vjetore, pagesa bëhet kryesisht me fletëpagesë (faturë) pas regjistrimit dhe pagesat vjetore përsëriten duke u bërë në fillim të vitit kalendarik.

10.7 Për shkak të dallimeve në standardin e jetesës në secilin shtet dhe rrethanave tjera, kryesia e shoqatës në koordinim me anëtarët e kryesisë do caktoj për secilin shtet shumën e pagesës vjetore.

8. Detyrimet

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të kryesisë së shoqatës

11.1 Pjesëmarrja

- a) Pjesëmarrja në vendime të rëndësishme për shoqatën
- b) Anëtarët mund të zgjedhin kryesinë dhe të kandidojnë për zgjedhje në kryesi
- c) Të marrin pjesë në aktivitetet që i organizon shoqata
- d) Të ruajnë imazhin e shoqatës
- e) Të pranojnë dhe respektojnë rregulloren e përgjithshme që e ka krijuar shoqata
- f) Rregullat tjera rreth detyrimeve do të përmirësohen gjatë mandatit të parë 1 vjeçar

11.2 Anëtarësimi në shoqatë përfundon me:

- a) Me largimin vullnetar nga shoqata i ndonjë anëtari duke e njoftuar kryesinë me shkrim ose forma tjera. Kjo mund të bëhet përmes kanaleve informuese të bazuar nga Neni 3

- b) Kuvendi i përgjithshëm mund të vendos që ta suspendoj (largoj) një ose më tepër persona për motive të arsyeshme, në veçanti kur një person i dëmton imazhin apo i sjell dëme shoqatës. Disa nga arsyet mund të jenë;
 - i. Mos pagesa e anëtarësisë më shumë se 6 muaj.
 - ii. Mos pjesëmarrja në mbledhje më shumë se 3 herë, pa arsye.
 - iii. Abuzimet dhe çdo keqpërdorim të mjeteve financiare dhe materiale.

11.3 Detyrime, përfitimet dhe disa rregulla tjera rreth anëtarëve të përgjithshëm do i publikojmë gjatë mandatit të parë 1 vjeçar.

9. Menaxhimi

Neni 12

Organet e shoqatës

- a) Bordi drejtues (Kryesia)
 - a. Kryetari
 - b. Arkëtari
 - c. Sekretari
- b) Anëtarët e kryesisë
(Në mandatin e parë, anëtarët e kryesisë janë themeluesit e shoqatës që kanë marrë pjesë në mbledhjen e parë dhe numëron 26 anëtarë (emrat janë cekur në faqen e parë tek Informacionet bazë – **Themeluesit**)
- c) Aktivistët
Aktivist janë punëtorët vullnetar që japin kontributin e tyre në forma të ndryshme në interes të shoqatës në përputhje me rregulloren apo statutin e shoqatës
- d) Grupet tjera
Kryesia dhe anëtarët e kryesisë janë të hapur për të diskutuar dhe themeluar edhe grupe tjera nëse ju përshtatën interesave të shoqatës bazuar në statutin dhe rregulloret tjera

12.1 Statuti i shoqatës ndryshohet me pëlqimin e 2/3 apo 66% të votave. Votat mund të jepen nga anëtarët e kryesisë ose nëse është e nevojshme, kryesia vendos që çështja mund të kalojë në votim publik tek të gjithë anëtarët e shoqatës ku secili anëtarë ka të drejtë me jap votën e vetë në mënyrë të fshehur d.m.th procesi i votimit do jetë i mbyllur (vota sekrete)

12.2 Në mandatet tjera, anëtarët e kryesisë caktohen nga votat e të gjithë anëtarëve me një proces të hapur që do publikohet në kanalet zyrtare të informimit 1 muaj para zgjedhjeve që do mbahet në Mars 2026. Në njoftim do jepen të gjitha sqarimet rreth procesit të votimit, propozimeve etj.

12.3 Në mandatin tjetër, organet drejtuese do të ristrukturohen dhe do hapen hapësira për tu përfaqësuar të gjitha shtetet me përfaqësuesit e tyre si pjesë e anëtarëve të kryesisë nën ombrellën **Shoqata “Liqeni i Breznës”**. Njoftimet dhe sqarimet tjera do publikohen tek kanalet zyrtare

12.4 Anëtarët e kryesisë zgjedhin bordin drejtues me një proces të hapur. Neni 12.2 do jap sqarime në detaje.

12.5 Kryesia së bashku me anëtarët e kryesisë do organizojnë 1 herë në vit, takim të hapur me banorët e fshatit Brezne në fillim të muajit Gusht. Agjenda do publikohet 1 muaj para takimit.

12.5 Kryesia e shoqatës do jetë në kontakt të rregullt me përfaqësuesit e fshatit Brezne për të koordinuar punën e bashkëpunimit sa më mire duke shfrytëzuar kanalet e informimit Neni 3

12.6 Rolet e bordit drejtues (Kryesia)

a) Kryetari

1. Udhëheq mbledhjet e kryesisë së bashku me arkëtarin
2. Në mungesë të kryetarit, mbledhjet udhëhiqen nga Sekretari ose ndonjë anëtar i kryesisë i caktuar nga kryetari
3. Përfaqëson shoqatën nëpër aktivitete të ndryshe dhe vepron në emër të saj
4. Koordinon bashkëpunimin me anëtarët e kryesisë dhe bashkëpunëtorët në atdhe

b) Arkëtar

1. Mban të dhënat dhe menaxhon financat e shoqatës
2. Ka qasje në sistemin elektronik të llogarisë bankare për menaxhimin e faturave apo pagesave tjera
3. Tërheqja e parave nga banka, bëhet në koordinim me Kryetarin dhe Sekretarin
4. Krijon raportin vjetor rreth të hyrave dhe daljeve nga llogaria bankare
5. Raportin vjetor e dërgon tek anëtarët e kryesisë për diskutim dhe pastaj bëhet publik për të gjithë anëtarët
6. Të gjitha raportet financiare arkivohen në databazën e shoqatës

c) Sekretari

1. Kryen punët administrative të shoqatës
2. Ruan arkivin e shoqatës dhe dokumentet tjera
3. Propozon rendin e ditës për mbledhjet e kryesisë
4. Ndërton dhe publikon agjendën e të gjitha takimeve
5. Ka qasje në postën elektronike (e-mail) zyrtare të shoqatës
6. Mban komunikimin me palët tjera

d) Rregullat tjera në të gjitha rolet e bordit drejtues do të përmirësohen gjatë mandatit të parë 1 vjeçar

12.7 Rolet e anëtarëve të kryesisë

- a) Kanë për detyrë të mbikëqyrin aktivitetet e bordit drejtues
- b) Bëjnë propozime rreth aktiviteteve të reja në koordinim me bordin drejtues
- c) Të gjitha vendimet do pranohen me shumicë votash d.m.th vendimet kalojnë në urdhër ekzekutiv kur përmbush së paku 51% të votave nga anëtarët e kryesisë që votojnë
- d) Kuorumi në pjesëmarrje duhet të jetë mbi 50 % për ta votuar një vendim
- e) Anëtarët e kryesisë kanë të drejt ta shkarkojnë bordin drejtues nëse gjejnë fakte se ata kanë shkelur rregullat e shoqatës të përcaktuara me rregullore. Votimi duhet të jetë me shumicë

- f) Kanë të drejtë të emërojnë anëtarë shtesë në bordin drejtues për ta lehtësuar punën e kryesisë
- g) Në rast se numri i anëtarëve të kryesisë bie nën kuotën 50% atëherë automatikisht nga kryesia e mbetur shpallen zgjedhjet e reja

12.8 Rolet e aktivistëve

- a) Kjo është një punë vullnetare për të gjithë ata që kanë dëshirë të kontribuojnë në zhvillimin e mëtutjeshëm të aktiviteteve të shoqatës duke u bazuar në statutin dhe rregulloret
- b) Aktivistët që janë të kyçur në aktivitetet e shoqatës, me ndonjë iniciativë apo projekt të veçantë, kanë të drejtë të marrin pjesë në disa mbledhje të kryesisë sipas nevojës dhe rolit që kanë në aktivitet
- c) Puna e aktivistëve duhet të aprovohet së pari nga anëtarët e kryesisë në koordinim me bordin drejtues

12.9 Rolet e grupeve tjera

- a) Çdo anëtarë ka të drejtë të jap propozime apo ide të reja dhe kryesia gjatë takimeve do i diskutoj dhe jap përgjigje individit apo grupit që ka bërë kërkesën
- b) Promovimi i aktiviteteve të shoqatës mund të bëhet nga të gjithë anëtarët duke ndjekur rregulloret të ndërtuara me statutin e shoqatës

10. Financimi

Neni 13

Burimet e shoqatës

13.1 Burimet e shoqatës burojnë nga anëtarësia e anëtarëve si dhe nga donacionet e personave fizik dhe juridik.

13.2 Mënyra tjera të lejuara me ligj

- a) Shërbimeve nëpër aktivitete ku përfitimet do shkojnë në fondin e shoqatës
- b) Sponsorët - të ardhurat nga përkrahja e bizneseve në aktivitetet e shoqatës
- c) Grantet apo fondet e dhëna për aktivitetet kulturore nga institucionet shtetërore, fondacionet dhe programeve tjera në kuadër të OJQ-ve

13.3 Shoqata ka llogarinë bankare, nëpërmjet së cilës kontrollohet dhe realizohet puna e shoqatës.

13.4 Shpërndarja e fondeve bëhet sipas programit të shoqatës.

13.4 Rregullat tjera shtesë do të përmirësohen gjatë mandatit të parë 1 vjeçar

Neni 14

Pushimi dhe dorëheqjet

14.1 Një anëtarë mund të largohet nga kryesia apo anëtarësia nëse shkel rregullat e shoqatës

14.2 Anëtarët e kryesisë kanë të drejt të japin dorëheqje dhe arsyeja nuk është e obligueshme për tu sqaruar pasi kjo është një punë vullnetare

14.3 Nëse një person jep dorëheqje nga Neni 16.2 përsëri ka të drejtë të jetë anëtar i shoqatës nëse i plotëson kushtet nga Neni 2 dhe Neni 10.5

Neni 15

Shuarja e shoqatës

15.1 Shoqata mund të ndal aktivitetet:

- a) Me sjelljen e vendimit nga anëtarët e kryesisë.
- b) Nëse numri i anëtareve zvogëlohet dukshëm.
- c) Nëse i ndalohet veprimtaria shoqatës nga organet shtetërore.
- d) Rregullat tjera shtesë do të përmirësohen gjatë mandatit të parë 1 vjeçar

Neni 16

Në rast të shpërbërjes ose pushimit të shoqatës, të mirat e shoqatës do ti jepen një institucioni kulturorë i cili do të zgjidhet nga anëtarët e kryesisë apo vendimi do kaloj me votim nga të gjithë anëtarët duke zgjedhur disa opsione të vendosura pas një diskutimi të përbashkët përmes kanaleve të informimit.

Neni 17

Shoqata ka cilësinë e personit juridik.

Neni 18

Statuti hyn në fuqi ditën e aprovimit të tij nga anëtarët e kryesisë duke dhënë urdhrin ekzekutiv bordit drejtues për zbatim në aktivitetet e shoqatës. Ky vendim u marrë në mbledhjen e kryesisë me datën 02.03.2025 në qytetin Regensdorf (kantoni Zürich) të Zvicrës.

Kryetari:

Sami Kryeziu

Statuti është dizajnuar nga kryesia e shoqatës “Liqeni i Breznës”

© 2025 Shoqata “Liqeni i Breznës”